

UDHËZUES

DESTINACIONI

EMIGRIMI

POLONI



→ **SHQIPËRIA JE TI!**

Mëso më shumë: www.albania.iom.int

POLONI

I. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Kryeqyteti: Varshava

Popullsia: 37.95 milion¹

Sipërfaqja e përgjithshme: 322,575km²

Gjuha kryesore: Polake

Monedha: Złoty Polak

Niveli i papunësisë: 3.37%²

Udhëtimi pa viza në Hapësirën Shengen

Qytetarët shqiptarë për të udhëtuar në Poloni për arsye turistike, familjare, biznesi apo studimi afatshkurtër deri në një afat 90 ditor brenda një harku kohor prej 180 ditësh, që nga momenti i parë i kalimit të kufirit të zonës Shengen nuk kanë nevojë të pajisen me viza afat shkurtër të tipit “C.” Për të përfituar nga ky regjim duhet që qytetarët të zotërojnë një pasaportë biometrike. Për të qëndruar me gjatë se 90 ditë ju duhet të aplikoni për vizë. Aplikimi për vize trajtohen nga Ambasada e Polonisë në Shqipëri, e cila ndodhet në Rrugën e Durrësit, 123, Tiranë, (<https://www.gov.pl/web/albania>)

II. ADRESA WEB TË RËNDËSISHME

- [More on visas](#)
- [Polish diplomatic missions abroad](#)
- [Online visa registration application](#)
- [Ministry of Foreign Affairs](#)
- [More on the application for legalisation](#)
- [More on working in Poland](#)
- [Poviat labour offices](#)
- [Voivodeship offices](#)
- [Office for Foreigners](#)
- [Ministry of Family, Labour and Social Policy](#)
- [Ministry of the Interior and Administration](#)
- [Information portal for migrants](#)
- [Border Guard](#)

III. EMIGRIMI NË POLONI PËR ARSYE PUNE

¹ <https://ec.europa.eu/eurostat/databroeser/viee/tps00001/default/table?lang=en>

² <https://ec.europa.eu/eurostat/documents/2995521/14636259/3-01062022-AP-EN.pdf/85134828-9c7a-898b-1636-00c24ddca735>

Kategoria : I / E Punësuar

Kushtet

Për të punuar në Poloni duhet që rrethanat e punës të justifikojnë qëndrimin për një periudhë më të gjatë se 3 muaj.

Ju duhet të keni:

- Një vize hyrjeje
- Një leje qëndrimi për pune

Procedurat

Kërkesa për lejen e qëndrimit duhet bërë personalisht, pranë ambasadës polake të vendit tuaj. Gjatë aplikimit jeni të detyruar të jepni shenjat e gishtave.

Viza

Ju duhet të merrni një vizë pranë ambasadës të vendit tuaj për të hyrë në Poloni.

Dokumentacioni i kërkuar

Për të marrë një leje pune, ju ose punëdhënësi juaj duhet të paraqisni:

- Formularin e plotësuar të aplikimit për leje qëndrimi të përkohshëm;
- 4 fotografi të përditësuara;
- Fotokopja e një dokumenti të vlefshëm udhëtimi (originali i disponueshëm për inspektim), në rast veçanërisht të justifikuar, nëse nuk keni dokumentacion të vlefshëm udhëtimi dhe nuk është e mundur të merret një dokument i tillë, mund të paraqisni një dokument tjetër që vërteton identitetin tuaj;
- Informacion nga punëdhënësi lidhur me vendin e punës lidhur me mungesën e mundësisë për të plotësuar nevojat e personelit të punëdhënësit bazuar në regjistrat e papunsisë ose punëkërkesve ose në rezultatin negativ të rekrutimit të organizuar për punëdhënësin.

Dokumentet standarde të nevojshme për shqyrtimin e aplikacionit:

Shënim: Dokumentet e renditura më poshtë bashkëngjitur aplikacionit mund të zvogëlojnë sasinë e korrespondencës zyrtare dhe të *shkurtojnë kohën e nevojshme për trajtimin e çështjes.*

- Dokumentin që konfirmon vendbanimin (p.sh. çertifikata e vendbanimit, kontrata e qirasë, kontrata tjetër që mundëson objektin e banimit, ose kërkesën e personit të autorizuar që t'i sigurojë të huajt vendbanimin);
- Kontrata e punës, së bashku me llogaritë e 3 muajve të fundit, kontratë specifike për detyrën;
- Vërtetim punësimi nga punëdhënësi i fundit (në rastin kur i huaji ka kryer punë te një punëdhënësi tjetër);
- Dokumentet për të vërtetuar një burim të qëndrueshëm dhe të rregullt të ardhurash, i cili është i përshtatshëm për të mbuluar shpenzimet e jetesës dhe anëtarët e familjes në ngarkim (për një person që mban një familje të vetme – në shumën më të lartë se 634 PLN neto në muaj, për personin në familje – në shumën më të lartë se 514 PLN neto

mujore), p.sh. kthimi vjetor i TAP-it në lidhje me shumën e të ardhurave të të huajit për vitin e fundit tatimor ose certifikatën e duhur nga Sigurimet Shoqërore (ZUS);

- Dokumentet që vërtetojnë sigurimin shëndetësor (p.sh. certifikata përkatëse nga Sigurimet Shoqërore (ZUS).

Vlefshmëria e lejeve dhe rinovimi

- Leja e përkohshme e qëndrimit jepet për një periudhë që është e nevojshme për të përfunduar objektin e këtij qëndrimi në territorin e Polonisë më shumë se 3 muaj deri në 3 vjet, me mundësinë për të aplikuar për leje të mëvonshme.

Ankesat

Ju mund të paraqisni një kërkesë për rishqyrtim të kërkesës për vizë te një konsull ose të ankimoni pranë Shefit të Zyrës për të Huajt. Ju mund të bëni një ankim të mëtejshëm përpara gjykatave administrative.

Të Drejtat

Aksesi në Punësim

Kjo leje jep të drejtën për të kryer punë. Karta e qëndrimit, e lëshuar në lidhje me lejen e përkohshme të qëndrimit, përmban shënimin “qasje në tregun e punës”.

- ndryshimi i subjektit që i beson punën (punëdhënësit) të treguar në këtë leje kërkon leje të re të përkohshme qëndrimi dhe pune;

Ndryshimi i zyrave qëndrore, vendbanimit, emrit, formës juridike të punëdhënësit, nuk kërkon ndryshime ose dhënien e lejes së re të përkohshme të qëndrimit dhe punës.

Aplikuesi mund të kryejë punë shtesë për një punëdhënës tjetër në bazë të një leje pune të veçantë – leja e punës për punonjesin, në këtë rast, i lëshohet punëdhënësit.

Leje qëndrimi të përhershme

Vendimi për dhënien e lejes së qëndrimit të përhershëm lëshohet për një afat të pacaktuar. Karta e qëndrimit mbetet e vlefshme për 10 vjet, që do të thotë se ajo duhet të zëvendësohet çdo 10 vjet. Një leje qëndrimi e përhershme e lëshuar në Poloni nuk i jep të drejtën të huajit të marrë punë në një vend tjetër. Një leje qëndrimi e përhershme i jep të huajit të drejtën të udhëtojë në vendet e tjera të zonës Shengen deri në 90 ditë në një periudhë 180-ditore për qëllime turistike.

Leje qëndrimi afatgjatë në BE

I huaji që ka qëndruar ligjrisht dhe në mënyrë të vazhdueshme në territorin e Republikës së Polonisë duke qëndruar për të paktën 5 vjet, i cili:

- ka një burim të ardhurash të qëndrueshme dhe të rregullta, të mjaftueshme për të mbuluar mjetet e jetesës për ata dhe anëtarët e familjes së tyre që varen prej tyre;
- ka sigurim shëndetësor.

I jepet leja për një kohë të pacaktuar.

Kategoria : Punonjës me kualifikim të lartë

Kushtet

Të huajt, qëllimi i qëndrimit të të cilëve në territorin e Republikës së Polonisë është kryerja e punës në një *profesion që kërkon kualifikime të larta*, që:

1. ka përfunduar universitetin; ose
2. ka të paktën 5 vjet përvojë profesionale në nivel të krahasueshëm me nivelin e kualifikimeve të marra si rezultat i diplomimit në universitet;
3. paga minimale që i ofrohet është 1193 EURO bruto mujore;
4. ka një vizë hyrëse

Mund ti jepet një leje qëndrimi si punonjës me kualifikim të lartë

Procedurat

Kërkesa për lejen e qëndrimit duhet bërë personalisht, pranë ambasadës polake të vendit tuaj. Gjatë aplikimit jeni të detyruar të jepni shenjat e gishtave.

Viza

Ju duhet të merrni një vizë pranë ambasadës të vendit tuaj për të hyrë në Poloni.

Dokumentet e kërkuara

Për të marrë lejen e qëndrimit si punonjës i kualifikuar duhet të keni:

- formularn e plotësuar të kërkesës për leje qëndrimi si punonjës me kualifikim të lartë;
- 4 fotografi të përditësuara
- fotokopjen e një dokumenti të vlefshëm udhëtimi (origjinali i disponueshëm për inspektim), në raste të jashtëzakonshme nëse i huaji nuk ka dokument të vlefshëm udhëtimi dhe nuk është e mundur të merret një dokument i tillë, mund të paraqesë një dokument tjetër që vërteton identitetin e tij/saj;
- **informacion nga punëdhënësi** për mungesën e mundësisë për të plotësuar nevojat e personelit bazuar në regjistrat e të papunëve ose në rezultatin negativ të rekrutimit të organizuar për punëdhënësin.
- kontratën e **punës të lidhur** për një periudhë të paktën 1 vjeçare, marrëveshjen e pagesës, kontratën civile në bazë të së cilës kryhet puna, ofrohen shërbimet ose ruhet marrëdhënia e punës;
- dokument që dëshmon se ka kualifikime profesionale universitare;
- dokument që dëshmon përmbushjen e kërkesave të kualifikimit dhe kushteve të tjera në rastin e synimit për të kryer punë në një profesion të rregulluar;
- lejen e organit kompetent për mbajtjen e një pozicioni të caktuar, kryerjen e një profesioni ose kryerjen e veprimeve të tjera, kur detyrimi për marrjen e tij para lidhjes së kontratës është i imponuar me rregullore të veçanta;
- dokumente që vërtetojnë **sigurimin shëndetësor** (p.sh. vërtetim përkatës nga Institucioni i Sigurimeve Shoqërore (ZUS)).

Kohëzgjatja e vlefshmërisë së lejes unike

- Lejet e sipërpërmendura jepen nëse rrethanat që janë bazë për aplikimin për këtë leje, justifikojnë qëndrimin e një të huaji në territorin e Republikës së Polonisë për një periudhë më të gjatë se 3 muaj.

- Leja jepet për një periudhë më të gjatë 3 muaj se periudha e kryerjes së punës, por jo më e gjatë se 3 vjet, me mundësi aplikimi për leje të mëvonshme.

Ankesat

Është e mundur të paraqisni një kërkesë për rishqyrtimin e kërkesës për vizë te një konsull ose të ankimoni një vendim negativ përpara Shefit të Zyrës për të Huajt. Ju mund të bëni një ankim të mëtejshëm përpara gjykatave administrative.

Të Drejtat

Aksesit në punë

I huaji mund të punojë në Poloni sipas kushteve të përcaktuara në këtë leje, pa pasur nevojë të ketë një leje pune shtesë. Karta e qëndrimit, e lëshuar në lidhje me lejen e përkohshme të qëndrimit, përmban shënimin “akses në tregun e punës”

Ndryshimi i vendit të punës

I huaji duhet t'i drejtohet departamentit kompetent për vendin e qëndrimit aktual të të huajit **për të ndryshuar lejen e qëndrimit të përkohshëm**, nëse i huaji synon të fillojë punën pranë çdo subjekti tjetër nga sa përcaktohet në leje, synon të ndryshojë pozicionin ose do të marrë një shpërblim më të ulët se sa përcaktohet në leje duhet të paraqesë kërkesë të re për leje qëndrimi.

Periudha e vlefshmërisë së lejes së ndryshuar nuk mund të kalojë 3 vjet nga data e lëshimit. Një i huaj ka mundësinë të aplikojë për një leje të re të përkohshme qëndrimi për të kryer punë në një profesion që kërkon kualifikime të larta.

Në periudhën e 2 viteve të para të qëndrimit të një të huaji në territorin e Republikës së Polonisë në bazë të kësaj leje:

1. i huaji nuk mund të fillojë kryerjen e punës në asnjë subjekt tjetër nga sa është përcaktuar në leje,
2. i huaji nuk mund të ndryshojë pozicionin në të cilin është i punësuar,

të huajit nuk mund t'i paguhet shpërblim më i ulët se sa është përcaktuar në leje - pa ndryshuar lejen.

Leje qëndrimi të përhershme

Vendimi për dhënien e lejes së qëndrimit të përhershëm lëshohet për një afat të pacaktuar. Karta e qëndrimit mbetet e vlefshme për 10 vjet, që do të thotë se ajo duhet të zëvendësohet çdo 10 vjet. Një leje qëndrimi e përhershme e lëshuar në Poloni nuk i jep të drejtën të huajit të marrë punë në një vend tjetër. Një leje qëndrimi e përhershme i jep të huajit të drejtën të udhëtojë në vendet e tjera të zonës Shengen deri në 90 ditë në një periudhë 180-ditore për qëllime turistike.

Më shumë për lejen e qëndrimit të përhershëm

Leje qëndrimi afatgjatë në BE

I huaji që ka qëndruar ligjërisht dhe në mënyrë të vazhdueshme në territorin e Republikës së Polonisë duke qëndruar për të paktën 5 vjet duhet të provojë që:

1. ka një burim të ardhurash të qëndrueshme dhe të rregullta, të mjaftueshme për të mbuluar mjetet e jetesës për ata dhe anëtarët e familjes së tyre që varen prej tyre;
2. ka sigurim shëndetësor.

Në mënyrë që t'i jepet leja për një kohë të pacaktuar.

I vetëpunësuar

Kushtet

Për t'u vetëpunësuar në Poloni ju duhet:

- një ftesë nga një kompani ekzistuese si bashkë-aksionar;
- vizë biznesi

Procedurat

Për të filluar aktivitetin tuaj si i vetëpunësuar në Poloni si fillim duhet të merrni një vizë biznesi dhe më pas duhet të merrni një ftesë. Për ta bërë këtë duhet të regjistroni një ndërmarrje në Poloni, dhe më vonë, në emër të kësaj kompanie, të lëshoni një ftesë. Qëllimi i mbërritjes me vizë biznesi duhet të dokumentohet.

Kryerja e aktivitetit individual të biznesit në Poloni kërkon regjistrim paraprak në Regjistrin Qendror dhe Informacion mbi Aktivitetin Ekonomik (*Centralna Eëidencja I Informacja O Działalności Gospodarczej*) (CEIDG). Kompania mund të regjistrohet personalisht si dhe përmes një avokati. Prokura për regjistrimin e shoqërisë duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e bordit drejtues të kompanisë.

Ku dhe si të aplikoni?

Të pasurit e një ftese nuk është një garanci për një vendim pozitiv për një vizë biznesi. Ju duhet të provoni se kompania është e nevojshme për ekonominë polake. Duhet të punësoni të paktën dy qytetarë polakë për kompaninë tuaj.

Viza

Viza merret në ambasadën polake të shtetit tuaj, pasi të paraqisni kërkesën të paguani tarifën e vizës dhe të kryeni intervistën. Ju mund të merrni një vizë biznesi në Poloni për raste të tilla:

- negociatat me partnerët nga pala polake;
- krijimi i marrëdhënieve të mundshme të biznesit;
- zgjidhja e çështjeve në një partneritet biznesi tashmë ekzistues;
- pjesëmarrja në konferenca biznesi;
- kryerja e veprimtarive sipërmarrëse.

Baza është një ftesë për një vizë biznesi nga një person juridik polak ose një sipërmarrës privat.

Dokumentat e dërguara për të marrë vizën duhet të tregojnë:

- qëllimin e udhëtimit;
- termat;
- të dhënat e kontaktit, emri i plotë, shtetësia, numri i identitetit të personit përgjegjës të palës ftuese;
- të njëjtat të dhëna për aplikantin.

Dokumentet e kërkuara

Për të marrë një vizë biznesi duhet të paraqisni:

- vërtetim për aftësinë financiare (statusi i llogarisë, vërtetimi i pagës, certifikata e

punësimit).

- të dhënat personale biometrike.
- në rastet kur aplikanti nuk aplikon në vendin e regjistrimit, do t'ju duhet të siguroni një vërtetim nga vendi i punës.
- nëse aplikimi dorëzohet në bazë të një kompanie të regjistruar për aplikantin, sigurohen dokumentet përbërës (kopjet dhe origjinali), si dhe një deklaratë nga autoritetet tatimore polake për mungesën e detyrimeve të prapambetura,
- dokumente shtesë, duke përfshirë biletat e udhëtimit, disponueshmërinë e banesave, etj.
- kërkesat për ftesën
- kërkesat për këtë dokument reduktohen në pikat e mëposhtme:
- nga një person juridik, një ftesë duhet të merret në letrën zyrtare me vulë.

Në aplikim duhet të specifikoni

- emrin e kompanisë dhe adresën,
- subjektin e veprimtarisë,
- shumën e kapitalit aksionar,
- përcaktimi nëse një aksionar mund të ketë më shumë se një aksion,
- mbiemrat, emrat dhe adresat ose adresat për dërgimin elektronik të anëtarëve të bordit drejtues dhe mënyrën e përfaqësimit të shoqërisë,
- kohëzgjatja e kompanisë,
- nëse kontrata specifikon një letër të destinuar për njoftimet e shoqërisë - përcaktimi i kësaj letre.

Përveç kësaj, aplikacioni duhet të paraqesë:

- një deklaratë e të gjithë anëtarëve të bordit drejtues se të gjitha kontributet janë bërë plotësisht nga të gjithë aksionarët,
- listën e ortakëve me emrin dhe mbiemrin ose emrin e shoqërisë dhe numrin dhe vlerën nominale të aksioneve të secilit prej tyre, dhe nëse shoqëria ka një aksioner të vetëm, tregoni edhe adresën e tij për shërbim,
- një listë që përfshin emrin dhe mbiemrin me një adresë shërbimi ose emrin e biznesit dhe selinë e anëtarëve të organeve ose personave të autorizuar për të emëruar bordin drejtues,
- mbiemrat, emrat dhe adresat e anëtarëve të bordit drejtues ose përfaqësuesve,
- një dokument për emërimin e anëtarëve të organeve drejtuese të shoqërisë, nëse nuk parashikohet në aktin noterial që përmban statutin,
- një deklaratë nga anëtarët e bordit drejtues ose përfaqësuesit se ata janë dakord për emërimin e tyre,
- prokurë me vërtetim të pagesës për prokurën – nëse aplikimi është paraqitur nga përfaqësuesi.
- Hapi tjetër është që partnerët të japin kontribute për të mbuluar kapitalin aksionar (të paktën 1051.06 EURO). Më pas, duhet të emërohet një bord drejtues dhe të krijohet një bord mbikëqyrës ose një komitet auditimi, në varësi të statutit. Hapi i fundit është regjistrimi në regjistrin e sipërmarrësve të Regjistrimit Kombëtar të Gjykatave.

Kohëzgjatja e vlefshmërisë së lejes dhe rinovimi

- Viza e biznesit mund të lëshohet për periudha të ndryshme dhe për numrin e hyrjeve: nga viza e zakonshme e biznesit (afatshkurtër) deri në afatgjatë.

- Nëse nevoja për pjesëmarrje në proceset e biznesit vërtetohet objektivisht, viza Shengen për biznes lëshohet për kohëzgjatjen e këtyre proceseve. Pas regjistrimit të mëvonshëm, ju mund të merrni vizë për një periudhë më të gjatë qëndrimi.

Ankesat

Ju mund të paraqisni një kërkesë për rishqyrtim të kërkesës për vizë te një konsull ose të ankimoni pranë Shefit të Zyrës për të Huajt. Ju mund të bëni një ankim të mëtejshëm përpara gjykatave administrative.

Të Drejtat

Aksesi në Punësim

Ndryshimi i zyrave qëndrore, vendbanimit, emrit, llojit të aktivitetit, kërkon ndryshime ose dhënien e një leje së re.

Leje qëndrimi afatgjatë në BE

I huaji që ka qëndruar ligjërisht dhe në mënyrë të vazhdueshme në territorin e Republikës së Polonisë duke qëndruar për të paktën 5 vjet, i cili:

- ka një burim të ardhurash të qëndrueshme dhe të rregullta, të mjaftueshme për të mbuluar mjetet e jetesës për ata dhe anëtarët e familjes së tyre që varen prej tyre;
- ka sigurim shëndetësor.

I jepet leja për një kohë të pacaktuar.

Kategoria: Punëtor Sezonal

Kushtet

Të huajt, qëllimi i qëndrimit të cilëve është të kryejnë punë sezonale, duhet të ketë:

Leje qëndrimi

Leje pune sezonale

Vizë hyrëse

Procedurat

- Të huajt që ka marrë lejen e përkohshme të qëndrimit i jepet një kartë qëndrimi, e shënuar “punë sezonale”.
- I huaji është i detyruar të largohet nga territori i Republikës së Polonisë brenda 30 ditëve nga dita kur vendimi për refuzimin e dhënies së lejes së përkohshme të qëndrimit.

Viza

Në rast të një pune sezonale afatshkurtër, duhet të aplikoni për një vizë hyrëse përpara se të mbërrini në Poloni. Aplikimi paraqitet personalisht në ambasadën polake të shtetit tuaj.

Ku dhe si të aplikoni

Kërkesa për leje qëndrimi të përkohshme duhet të paraqitet personalisht nga ju, në ambasadën polake të shtetit e shtetësisë tuaj.

Dokumentet e kërkuara

Për të marrë një leje qëndrimi të përkohshme:

- Katër fotografi;
- Kopje të një dokumenti të vlefshëm udhëtimi (original për inspektim), në raste të jashtëzakonshme, kur personi nuk ka dokument të vlefshëm udhëtimi dhe është e

pamundur ta marrë atë, ai/ajo mund të paraqesë një dokument tjetër vërtetues identiteti.

- Dokument që konfirmon se i huaji ka hyrë në territorin e Republikës së Polonisë në bazë të një vize të lëshuar për qëllime të punës sezonale;
- Leje pune sezonale ose zgjatje e lejes se punës sezonale;
- Dokumentet që vërtetojnë një burim të ardhurash të qëndrueshme dhe të rregullta për të mbuluar shpenzimet e jetesës për veten dhe çdo anëtar të familjes në varësi;
- dokumente që vërtetojnë sigurimin shëndetësor ;
- Dokumenti që konfirmon vendin e akomodimit të ofruar (p.sh. konfirmimi i regjistrimit, kontrata e qirasë së apartamentit, kontratë tjetër që mundëson posedimin e banesës ose deklaratën e një personi të autorizuar për posedimin e banesës për dhënien e një vendbanimi të huajit).

Kohëzgjatja e vlefshmërisë së lejes

Kjo leje jepet për periudhën e lejes për punë sezonale, jo më shumë se 9 muaj. Leja mund të jepet gjithashtu nëse rrethanat, të cilat përbëjnë bazën për aplikimin për leje, nuk e justifikojnë qëndrimin e të huajit brenda territorit të Republikës së Polonisë për një periudhë më të gjatë se 3 muaj.

Ankesat

Ju mund të bëni ankim administrativ në Drejtorinë e Policisë së Jashtme/Drejtorinë e Policisë Kufitare dhe të Jashtme ose një ankim gjyqësor në Gjykatën Rajonale.

Të Drejtat

Ndryshimi i punësimit

Ndryshimi i arsyes së qëndrimit, punëdhënësit, vendbanimit, emrit, llojit të aktivitetit, kërkon ndryshim ose dhënien e një leje së re.

Leje qëndrimi afatgjatë në BE

I huaji që ka qëndruar ligjrisht dhe në mënyrë të vazhdueshme në territorin e Republikës së Polonisë duke qëndruar për të paktën 5 vjet, i cili:

- ka një burim të ardhurash të qëndrueshme dhe të rregullta, të mjaftueshme për të mbuluar mjetet e jetesës për ata dhe anëtarët e familjes së tyre që varen prej tyre;
- ka sigurim shëndetësor.

I jepet leja për një kohë të pacaktuar.

IV. EMIGRIMI NË POLONI PËR ARSYE TË BASHKIMIT FAMILJAR

Bashkim familjar

Kushtet :

I huaji që banon në territorin e Polonisë, mund të bashkohet me familjarët e tij:

- në bazë të lejes së qëndrimit të përhershëm,
- në bazë të lejes së qëndrimit për rezident afatgjatë të BE-së,
- në bazë të lejes së përkohshme të qëndrimit për të kryer kërkime shkencore,
- në bazë të lejes së qëndrimit të përkohshëm që është dhënë për të kryer kërkime,

- në bazë të lejes së përkohshme të qëndrimit për të kryer një punë të kualifikuar, Familjarë do të konsiderohet:
 1. personi i cili mbetet në marrëdhënie martesore;
 2. fëmijë i mitur i të huajt dhe bashkëshortit/es, përfshirë fëmijën e birësuar;
 3. fëmijë i mitur i të huajt, duke përfshirë fëmijën e adoptuar që është në varësi të të huajt;
 4. fëmijë i mitur i bashkëshortit/es duke përfshirë fëmijën e birësuar që është në ngarkim të tij/saj.

Procedurat:

Ku dhe si të aplikoni
Kërkesa për një anëtar të familjes bëhet nga i huaji që jeton në territorin e Republikës së Polonisë. Prania e një familjari për të cilin i huaji bën kërkesën nuk është e detyrueshme.

Prezenca e familjarëve të lartpërmendur do të jetë e detyrueshme pas dhënies së vendimit për dhënien e lejes së qëndrimit të përkohshëm, gjatë aplikimit për lëshimin e kartës së qëndrimit për marrjen e shenjave të gishtave.

Dokumentet e kërkuara

Për të marrë leje qëndrimi mbi bazën e bashkimit familjar duhet të dorëzoni:

- formularin e plotësuar të aplikimit për qëndrim të përkohshëm;
- 4 fotografi të përditësuara
- fotokopjen e një dokumenti të vlefshëm udhëtimi (origjinali i disponueshëm për inspektim), në raste të jashtëzakonshme nëse i huaji nuk ka dokument të vlefshëm udhëtimi dhe nuk është e mundur të merret një dokument i tillë, mund të paraqesë një dokument tjetër që vërteton identitetin e tij/saj;
- dokumentet që vërtetojnë shkallën e lidhjes farefisnore (kopje e akteve të gjendjes martesore: kopje e certifikatës së martesës, kopje e certifikatës së lindjes);
- dokumentet që konfirmojnë **një burim të qëndrueshëm dhe të rregullt të të ardhurave**, i cili është i mjaftueshëm për të mbuluar shpenzimet e jetesës dhe anëtarët e familjes në ngarkim;
- dokumentet që vërtetojnë se një i huaj që aplikon për këtë leje ka një **sigurim shëndetësor**;
- një dokument që konfirmon **vendbanimin** e ofruar, p.sh. një vërtetim i vendbanimit, kontrata e qirasë së një banese, kontratë tjetër që mundëson përdorimin e objekteve të banimit, ose një deklaratë e një personi të autorizuar të disponojë objektin e banimit për të siguruar një vendbanim për i huaji).

Kohëzgjatja e vlefshmërisë së lejeve dhe rinovimi

- Lejet e përkohshme të qëndrimit do të jepen nëse rrethanat që janë bazë për të aplikuar për këtë leje justifikojnë qëndrimin në territorin e Republikës së Polonisë për një periudhë më të gjatë se 3 muaj.
- Leja e përkohshme e qëndrimit jepet për një periudhë që është e nevojshme për të përfunduar objektin e këtij qëndrimi në territorin e Polonisë *më shumë se 3 muaj deri në 3*

vjet, me mundësinë për të aplikuar për leje të mëvonshme.

Ankesat

Kërkesa për rishqyrtim të kërkesës për vizë është e mundur të paraqitet te një konsull ose të ankimohet vendimi negativ për dhënien e lejes së qëndrimit pranë Shefit të Zyrës për të Huajt. Një ankim tjetër mund të bëhet para gjykatave administrative.

Të drejtat

Akses në punësim

Kjo leje jep të drejtën për të kryer punë pa dokument shtesë. Karta e qëndrimit, e dhënë në lidhje me këtë leje, përmban shënimin “akses në tregun e punës”.

Akses në arsim

Një anëtar i familjes, i cili ka një leje qëndrimi në bazë të bashkimit familjar, ka akses të barabartë në të gjitha nivelet e arsimit.

V. EMIGRIM PER ARSYE STUDIMI DHE KËRKIMI SHKENCOR

Kërkues Shkencor

Kushtet:

Kërkuesi shkencor i cili dëshiron të shkojë në Poloni për

- të kryer punë kërkimore ose zhvillimore
- në bazë të marrëveshjes së pritjes për qëllime të kryerjes
- një projekt kërkimor të përfunduar me një institucion kërkimor në territorin e Republikës së Polonisë.

Ka të drejtën të aplikojë për leje qëndrimi si kërkues shkencor.

Procedurat:

Marrëveshja e pritjes mund të lidhet ndërmjet studiuesit dhe institucionit kërkimor. Lista aktuale e institucioneve të miratuara kërkimore është publikuar në fletoren zyrtare të ministrit kompetent për arsimin. Institucioni kërkimor mund të lidhë marrëveshjen e pritjes me studiuesin kur:

- projekti është miratuar nga autoritetet përkatëse të njësisë shkencore;
- studiuesi për kohën e qëndrimit në territorin e Republikës së Polonisë ka:
 - a) fonde të mjaftueshme për të mbuluar kostot e tij,
 - b) sigurimin shëndetësor.

Autoritetet kompetente të institucionit kërkimor gjatë analizës së miratimit të projektit kërkimor, marrin parasysh:

- qëllimin dhe kohëzgjatjen e punëve kërkimore ose zhvillimore dhe fondet e nevojshme për zbatimin e tyre;
- dokumentet që vërtetojnë kualifikimet e studiuesit të cilat janë të rëndësishme për shkak të punëve të kryera kërkimore ose zhvillimore.

Marrëveshja e pritjes për qëllime të realizimit të projektit kërkimor është lidhur si kontratë

pune, duke përfshirë, në veçanti:

1. detyrimin e: a) hulumtuesit për të marrë pjesë në projektin kërkimor, b) institucionit kërkimor t'i krijojë studiuesit kushtet përkatëse për të zbatuar detyrimet e tij/saj;
 2. identifikimi i shpërblimit të studiuesit dhe kushteve të punës së tij/saj.
- Gjithashtu, institucioni kërkimor duhet të lëshojë për studiuesin deklaratën përkatëse me shkrim, në të cilën ai merr përsipër të përballojë shpenzimet e qëndrimit, si dhe koston e ekzekutimit të vendimit që detyron të huajin të largohet nga vend, 6 muaj nga data e skadimit të marrëveshjes së pritjes, nëse baza për nxjerrjen e vendimit që detyron të huajin të kthehet është qëndrimi i tij/saj i paligjshëm në territorin e Republikës së Polonisë.

Ku dhe si të aplikoni

I huaji e bën kërkesën personalisht, në ambadasën polake të shtetit ku ai/a jo banon. Gjatë aplikimit i huaji është i detyruar të japë shenjat e gishtave.

Dokumentet e kerkuara

Për lejen e qëndrimit si kërkues shkencor kërkohet:

- formulari i plotësuar i aplikimit për leje;
- 4 fotografi të përditësuara
- fotokopja e një dokumenti të vlefshëm udhëtimi (origjinali i disponueshëm për inspektim), në raste të jashtëzakonshme nëse i huaji nuk ka dokument të vlefshëm udhëtimi dhe nuk është e mundur të merret një dokument i tillë, mund të paraqesë një dokument tjetër që vërteton identitetin e tij/saj.
- **marrëveshja e pritjes** për qëllime të realizimit të projektit kërkimor e lidhur me një institucion kërkimor me qendër në territorin e Republikës së Polonisë (*kërkuesi që ka lejen e qëndrimit me shënimin “kërkues”, të lëshuar nga një shtet tjetër anëtar i be-së paraqet marrëveshjen e pritjes të lidhur me institucionin kërkimor me seli në territorin e një shteti tjetër anëtar të be-së*);
- **deklaratë me shkrim e institucionit kërkimor**, në të cilin merr përsipër të përballojë shpenzimet e qëndrimit të studiuesit, si dhe koston e ekzekutimit të vendimit që detyron të huajin të largohet nga vendi i mbuluar nga fondet publike përpara përfundimi i 6 muajve nga data e skadimit të kontratës nëse baza për nxjerrjen e këtij vendimi që detyron të huajin të largohet nga vendi është qëndrimi i tij/saj i paligjshëm në territorin e republikës së polonisë;
- **sigurimi shëndetësor**;
- fonde të mjaftueshme **për të mbuluar shpenzimet e jetesës dhe shpenzimet e udhëtimit** të kthimit në vendin e origjinës ose të vendbanimit ose koston e tranzitit në një vend të tretë i cili do të japë lejen e udhëtimit ose do të dorëzojë dokumente që vërtetojnë këto fonde.

Kohëzgjatja e vlefshmërisë së lejeve

Vendimi për miratimin e institucionit kërkimor do të nxirret me kërkesë të tij për një periudhë 5-vjeçare ose – në raste veçanërisht të justifikuara – për një periudhë më të shkurtër.

Ankesat

Është e mundur të paraqisni një kërkesë për rishqyrtimin e kërkesës për vizë te një konsull ose të ankimoni një vendim negativ për t'ju dhënë leje qëndrimi përpara Shefit të Zyrës për të Huajt. Ju mund të bëni një ankim të mëtejshëm përpara gjykatave administrative.

Të drejtat:

Akses në punësim

Kjo leje jep të drejtën për të kryer punë *pa pasur nevojë për leje shtesë pune*. Karta e qëndrimit, e lëshuar në lidhje me lejen e përkohshme të qëndrimit, përmban shënimin “akses në tregun e punës”.

Leje qëndrimi të përhershme

Vendimi për dhënien e lejes së qëndrimit të përhershëm lëshohet për një afat të pacaktuar. Karta e qëndrimit mbetet e vlefshme për 10 vjet, që do të thotë se ajo duhet të zëvendësohet çdo 10 vjet. Një leje qëndrimi e përhershme e lëshuar në Poloni nuk i jep të drejtën të huajt të marrë punë në një vend tjetër. Një leje qëndrimi e përhershme i jep të huajt të drejtën të udhëtojnë në vendet e tjera të zonës Shengen deri në 90 ditë në një periudhë 180-ditore për qëllime turistike.

Leje qëndrimi afatgjatë në BE

I huaji që ka qëndruar ligjërisht dhe në mënyrë të vazhdueshme në territorin e Republikës së Polonisë duke qëndruar për të paktën 5 vjet dhe plotëson kushtet e mëposhtme:

1. ka një burim të **ardhurash të qëndrueshme dhe të rregullta**, të mjaftueshme për të mbuluar mjetet e jetesës për ata dhe anëtarët e familjes së tyre që mbahen prej tyre;
2. ka **sigurim shëndetësor**

Mund të marre leje qëndrimi me afat të pacaktuar.

Student

Kushtet :

Mund të aplikoni për leje qëndrimi si student nëse:

- doni të ndiqni studime universitare me kohë të plotë; ose
- studime doktorature me kohë të plotë; ose
- kurs përgatitor për të filluar studime të tilla në gjuhën polake,

Me kusht që këto rrethana të justifikojnë qëndrimin tuaj në territorin e Republikës së Polonisë për një periudhë më të gjatë se 3 muaj. Duhet poashtu një vizë hyrëse.

Procedurat

I huaji e bën kërkesën personalisht, në ambasadën polake të shtetit ku ai/ajo banon. Gjatë aplikimit i huaji është i detyruar të japë shenjat e gishtave.

Viza

Ju duhet të merrni një vizë hyrëse, pranë ambasadës polake në vendin tuaj, përpara mbërritjes tuaj të synuar në Poloni.

Leja e qëndrimit

Kërkesa për qëndrim të përkohshëm për qëllime studimi kryhet personalisht në ambasadën polake në shtetin tuaj.

Dokumentacioni i kërkuar

Për të marrë një leje qëndrimi për kërkuesit shkencorë duhet të tregoni:

- formularin e plotësuar i aplikimit për leje qëndrimi të përkohshëm, në përputhje me informacionin;
- 4 fotografi;
- fotokopjen e një dokumenti të vlefshëm udhëtimi (origjinali i disponueshëm për inspektim), në raste të jashtëzakonshme nëse i huaji nuk ka dokument të vlefshëm udhëtimi dhe nuk është e mundur të merret një dokument i tillë, mund të paraqesë një dokument tjetër që vërteton identitetin e tij/saj.
- një vërtetim në lidhje me regjistrimin në programin e studimit ose studimet e vazhdueshme ose pranimin për një kurs përgatitor;
- dëshmi për pagesën e tarifës për studime nëse i huaji fillon ose vazhdon studimet me tarifë;
- dokumentet që konfirmojnë sigurimin shëndetësor;
- dokumentet që vërtetojnë se kanë mjete të mjaftueshme financiare për të mbuluar shpenzimet e jetesës dhe kthimin në shtetin e origjinës ose vendbanimit ose kostot e tranzitit në një shtet të tretë që do të lejojë aksesin dhe kostot e studimeve.

Kohëzgjatja e vlefshmërisë së lejes

- *Leja e parë* për qëllime arsimore në universitet jepet për një periudhë *15 mujore*. Nëse studimet justifikojnë qëndrimin e një të huaji në territorin e Republikës së Polonisë për një periudhë më të shkurtër se 1 vit, leja e parë jepet për periudhën e vitit akademik ose studimet.
- Leja pasuese e përkohshme e qëndrimit jepet për një periudhë të nevojshme për arritjen e qëllimit të qëndrimit të një të huaji në territorin e Republikës së Polonisë, por *jo më shumë se 3 vjet*.
- Një leje qëndrimi e përkohshme për të huajt që synojnë të ndjekin një kurs përgatitor për të filluar arsimin në një universitet të *zhvilluar në gjuhën polake*, jepet për një periudhë të kohëzgjatjes së këtij kursi të zgjatur me 3 muaj.

Ankesat

Një kërkesë për rishqyrtim të kërkesës për vizë është e mundur të paraqitet te një konsull ose të ankimohet vendimi negativ për dhënien e lejes së qëndrimit pranë Shefit të Zyrës për të Huajt. Ju mund të bëni një ankim të mëtejshëm përpara gjykatave administrative.

Të drejtat:

Aksesi në punësim

Pas marrjes së kësaj leje, një i huaj mund të kryejë punë në Poloni pa pasur nevojë të ketë një leje pune. Karta e qëndrimit, e lëshuar në lidhje me lejen e përkohshme të qëndrimit, përmban shënimin “akses në tregun e punës”.

Leje qëndrimi të përhershme

Vendimi për dhënien e lejes së qëndrimit të përhershëm lëshohet për një afat të pacaktuar. Karta e qëndrimit mbetet e vlefshme për 10 vjet, që do të thotë se ajo duhet të

zëvendësohet çdo 10 vjet. Një leje qëndrimi e përhershme e lëshuar në Poloni nuk i jep të drejtën të huajt të marrë punë në një vend tjetër. Një leje qëndrimi e përhershme i jep të huajt të drejtën të udhëtojnë në vendet e tjera të zonës Shengen deri në 90 ditë në një periudhë 180-ditore për qëllime turistike.

Leje qëndrimi afatgjatë në BE

I huaji që ka qëndruar ligjërisht dhe në mënyrë të vazhdueshme në territorin e Republikës së Polonisë duke qëndruar për të paktën 5 vjet dhe plotëson kushtet e mëposhtme:

1. ka një burim të **ardhurash të qëndrueshme dhe të rregullta**, të mjaftueshme për të mbuluar mjetet e jetesës për ata dhe anëtarët e familjes së tyre që mbahen prej tyre;
2. ka **sigurim shëndetësor**

Mund të marre leje qëndrimi me afat të pacaktuar.

VI. EMIGRIMI PER ARSYE TE TJERA

Kategoria : Praktikant/stazhier

Kushtet :

Nëse planifikoni të qëndroni në Poloni për më shumë se 3 muaj dhe qëllimi juaj kryesor i qëndrimit në Poloni është të merrni pjesë në një kurs trajnimi profesional ose stazh, duhet të aplikoni për lejen e qëndrimi të përkohshëm qëndrimit për një praktikant. Ju duhet të keni:

- Një marrëveshje/kontratë me institucionin
- Një vizë hyrëse
- Një leje qëndrimi të përkohshëm

Procedurat:

Praktika do të thotë që ju do të kryeni detyra me qëllim të marrjes së njohurive, aftësive praktike dhe përvojës profesionale, por nuk do të kryeni punë. Praktika duhet të jetë adekuate me fushën dhe nivelin e studimeve të përfunduara ose në vazhdim.

Viza

Duhet të merrni një vizë hyrëse në ambasadën polake në vendin tuaj, përpara mbërritjes tuaj të synuar në Poloni.

Leja e qëndrimit

Leja/Karta e qëndrimit lëshohet pasi të jetë marrë vendimi për lejen tuaj.

Dokumentet e kërkuara

Ju duhet të paraqisni dokumentet e mëposhtme:

- aplikimin e plotësuar në përputhje me udhëzimet;
- 4 fotografi;
- një fotokopje e një dokumenti të vlefshëm udhëtimi (origjinali për inspektim), në një rast veçanërisht të justifikuar, kur nuk keni ndonjë dokument të vlefshëm udhëtimi dhe nuk jeni në gjendje ta merrni një të tillë, mund të paraqisni një dokument tjetër që konfirmon identitetin tuaj;
- nëse aplikoni për lejen e përkohshme të qëndrimit për një praktikant ose vullnetar, duhet të paraqisni "Aneksin nr. 3" së bashku me formularin e aplikimit,
- Vërtetim i diplomimit nga universiteti brenda 2 viteve të fundit (p.sh. diplomë që vërteton përfundimin e universitetit) ose një dokument që konfirmon studimet e vazhdueshme në universitetin që ndodhet jashtë Bashkimit Evropian,
- Kontrata me shkrim e lidhur midis jush dhe organizatorit të praktikës,

- Deklarata me shkrim e organizatorit të praktikës për mbulimin e shpenzimeve për nxjerrjen dhe zbatimin e vendimit për detyrimin e të huajit për t'u kthyer.
- sigurimi shëndetësor;
- konfirmim se keni fonde të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e qëndrimit tuaj në Poloni dhe biletën e kthimit në vendin e origjinës për periudhën e praktikës (pas zbritjes së kostove të strehimit),
- deklarata e kostos së vendbanimit.
- **Kërkesa të mëtejshme**

Kontrata mbi bazën e së cilës i huaji do të kryejë praktikën duhet të lidhet me shkrim me organizatorin e praktikës dhe duhet të specifikojë:

- një përshkrim të programit të praktikës, duke përfshirë informacionin për qëllimin e tij arsimor ose komponentët arsimorë, trajnimin teorik dhe praktik, vendin ku do të zhvillohet praktika, gjuhën në të cilën do të zhvillohet praktika, nivelin e njohurive gjuhësore të nevojshme për praktikën, qëllimin dhe llojin e detyrave të kryera, njohuritë, aftësitë praktike dhe përvojën profesionale që do të fitohet,
- kohëzgjatjen e praktikës,
- kushtet e kryerjes dhe mbikëqyrjes së praktikës,
- orët e praktikës,
- të drejtat dhe detyrimet e palëve në lidhje me:
 1. mbulimet e shpenzimeve e praktikës,
 2. ekzaminimet e nevojshme mjekësore,
 3. sigurimi i aksidenteve,
 4. ditët e pushimit
 5. kushtet e zgjidhjes së kontratës,
- metodën e konfirmimit të njohurive të fituara, aftësive praktike dhe përvojës profesionale.

Kohëzgjatja e vlevshmërisë së lejes

Leja mund të jepet për periudhën e nevojshme për realizimin e kontratës, në bazë të së cilës do të kryhet praktika, *jo më pak se 3 muaj dhe jo më i gjatë se 1 vit.*

Ankesat

Ju mund të bëni ankim administrativ në Drejtorinë e Policisë së Jashtme/Drejtorinë e Policisë Kufitare dhe të Jashtme ose një ankim gjyqësor në Gjykatën Rajonale.

Të drejtat

Aksesi në punësim

Leja e përkohshme e qëndrimit për një praktikant ose një vullnetar nuk ju jep asnjë të drejtë për të kryer punë pa marrë një leje pune shtesë.

Ndryshimi i statusit

Në rast se doni të ndryshoni statusin e qëndrimit, jeni i detyruar të informoni Guvernatorin përkatës të provincës që ju ka dhënë lejen e qëndrimit të përkohshëm se arsyet për dhënien e saj nuk vlejnë më. Ju duhet ta bëni këtë brenda 15 ditësh.

Qëndrim afatgjatë

Si praktikant nuk mund të marrësh qëndrim afatgjatë. Është e nevojshme që fillimisht të merrni një leje të përkohshme për një qëllim tjetër (p.sh. punësim) dhe vetëm atëherë mund të aplikoni për leje qëndrimi afatgjatë.

Vullnetar

Kushtet :

Nëse planifikoni të qëndroni në Poloni për më shumë se 3 muaj dhe qëllimi juaj kryesor i qëndrimit në Poloni është të merrni pjesë në Shërbimin Vullnetar Evropian, duhet të aplikoni për lejen e qëndrimi të përkohshëm qëndrimit për një vullnetar. Ju duhet të keni:

- Një marrëveshje/kontratë me organizatën
- Një vizë hyrëse
- Një leje qëndrimi të përkohshëm

Procedurat:

Organizata vullnetare, në të cilën do të ofroni shërbim vullnetar, duhet të autorizohet nga ministri kompetent për punët e brendshme.

Viza

Duhet të merrni një vizë hyrëse në ambasadën polake në vendin tuaj, përpara mbërritjes tuaj të synuar në Poloni.

Leja e qëndrimit

Leja/Karta e qëndrimit lëshohet pasi të jetë marrë vendimi për lejen tuaj.

Dokumentet e kërkuara

Ju duhet të paraqisni dokumentet e mëposhtme:

- aplikimin e plotësuar në përputhje me udhëzimet;
- 4 fotografi;
- një fotokopje e një dokumenti të vlefshëm udhëtimi (originali për inspektim), në një rast veçanërisht të justifikuar, kur nuk keni ndonjë dokument të vlefshëm udhëtimi dhe nuk jeni në gjendje ta merrni një të tillë, mund të paraqisni një dokument tjetër që konfirmon identitetin tuaj;
- nëse aplikoni për lejen e përkohshme të qëndrimit për një praktikant ose vullnetar, duhet të paraqisni “Aneksin nr. 3” së bashku me formularin e aplikimit,
- *marrëveshje vullnetare* me shkrim e lidhur mes jush dhe organizatës vullnetare.
- sigurimi shëndetësor;
- konfirmim se keni fonde të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e qëndrimit tuaj në Poloni dhe biletën e kthimit në vendin e origjinës për periudhën e vullnetarizmit (pas zbritjes së kostove të strehimit),
- deklarata e kostos së vendbanimit.
- **Kërkesa të mëtejshme**

Një marrëveshje në bazë të së cilës ju do të kryeni shërbimet si vullnetar. Marrëveshja duhet të specifikojë:

- përshkrimin e punës vullnetare
- kohëzgjatjen e vullnetarizmit,
- kushtet për vullnetarizëm dhe mbikëqyrje,
- orët vullnetare,
- fondet për të mbuluar koston e jetesës dhe akomodimit tuaj dhe shumën minimale të parave të xhepit që merrni,
- trajnimet që duhet t'i nënshtroheni për të qenë vullnetar.

Kohëzgjatja e vlevshmërisë së lejes

Leja mund të jepet për periudhën e nevojshme për realizimin e kontratës, në bazë të së cilës do të bëhet vullnetarizmi, *jo më pak se 3 muaj dhe jo më i gjatë se 1 vit.*

Ankesat

Ju mund të bëni ankim administrativ në Drejtorinë e Policisë së Jashtme/Drejtorinë e Policisë Kufitare dhe të Jashtme ose një ankim gjyqësor në Gjykatën Rajonale.

Të drejtat

Aksesi në punësim

Leja e përkohshme e qëndrimit për një praktikant ose një vullnetar nuk ju jep asnjë të drejtë për të kryer punë pa marrë një leje pune shtesë.

Ndryshimi i statusit

Në rast se doni të ndryhoni statusin e qëndrimit, jeni i detyruar të informoni Guvernatorin përkatës të provincës që ju ka dhënë lejen e qëndrimit të përkohshëm se arsyet për dhënien e saj nuk vlejnë më. Ju duhet ta bëni këtë brenda 15 ditësh.

Qëndrim afatgjatë

Si vullnetar nuk mund të marrësh qëndrim afatgjatë. Është e nevojshme që fillimisht të merrni një leje të përkohshme për një qëllim tjetër (p.sh. punësim) dhe vetëm atëherë mund të aplikoni për leje qëndrimi afatgjatë.